

Dr. Vehbetu Zuhejli

Istihsan

VII

Pjesë e shkëputur nga “Usuli fikhu islam”

Autori:
Dr. Vehbetu Zuhejli

Përktheu:
Dr. Musli Vërbani

Titulli:
Istihsani

Korrektura:
Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Burimet (argumentet) mbështetëse (plotësuese) të ligjeve ose argumentet për të cilat dijetarët nuk janë pajtuar

Kemi shkruar më herët për argumentet e sheriatit, për të cilat janë pajtuar shumica absolute (dërrmuese) e dijetarëve. Në këtë kapitull do të përqendrohemi për argumentet më të rëndësishme për të cilat nuk janë pajtuar dijetarët e medhhebeve, për shkak të zgjedhjes së rrugëve të ndryshme të ixhtihadit ose për shkak të të vepruarit të shumtë apo të paktë me ato burime. Këto argumente bëjnë pjesë në të ashtuquajturën *kërkim argumentimi* apo me çka ka të bëjë me *kërkesën e argumentimit*.

Istidlal – gjuhësisht ka kuptimin: Kërkesa e argumentit dhe rruga e cila shpie te e kërkuara.

Istidlal – në terminologjinë e ekspertëve të usulit është shprehje për argumentin i cili nuk ka tekst, as ixhmaë dhe as kijasë.¹ Është i shumëllojtë: E para: Përbashkimi në mes të dy ligjeve, pa u përcaktuar arsyeja, sepse në të kundërtën do të ishte kijasë. *Shembull*: çdo abdes është adhuring, çdo adhuring i paramendohet nijeti, atëherë është e domosdoshme që çdo abdes të paramendohet se e ka nijetin.

E dyta: Istis'habi.

E treta: Ligji para nesh (paraprak).

E katërta: Istihسانی. Në këtë bazohen Hanefijjtë, Hanbelijjtë dhe Malikijjtë.

E pesta: Interesi korrespondent. Në këtë bazohen Malikijjtë.

Sa i përket asaj se çka ndërlidhet me kërkimin e argumentimit, janë:

- mendimi i sehabiut;
- tradita;
- seddu dhirai.

Unë do të shkruaj për burimet e njohura, si në vijim:

- Istihسانی;
- Parimi i interesit;
- istis'habi;
- tradita;
- mendimi i sehabiut;

- ligji para nesh; dhe
- seddu dhirai.

Do të bëjë një njoftim të shkurtër për disa argumente të tjera në të cilat bazohen disa medhhebe.

Duhet ditur se argumentet e ligjësimit, në përgjithësi, të disa fukaha arrin në nëntëmbëdhjetë argumente, e disa kanë arritur t'i numërojnë dyzetë e disa argumente.²

Duhet të sinjalizoj se, disa argumente janë të papranuara, pasi që janë të përziera dhe të falsifikuara nga terminologji bashkëkohore, në të cilat dominon epshi, emocionet dhe mendimet e shtrembëruara në sferën e ligjit të Allahut.

Ky nënkapitull (BURIMET MBËSHTETËSE) përmban nëntë tema:

- Tema e parë: Istihsan;
- Tema e dytë: Interesi korrespondent;
- Tema e tretë: Tradita;
- Tema e katërt: Ligji para nesh;
- Tema e pestë: Mendimi i sehabiut;
- Tema e gjashtë: Istis'habi;
- Tema e shtatë: Edh-Dherai;
- Tema e tetë: Argumentet tjera në fikhun e mospajtimeve;
- Tema e nëntë: Burimet e fikhut, të cilat nuk janë të sheriatit.

Istihsani

Hanefijët janë të njohur me atë se veprojnë me argumentin e *istihsanit*, prandaj lexuesi i librave të tyre e sheh shpesh këtë shprehje: ***Në bazë të kijasit, ky ligj është kështu, ndërsa në bazë të istihsanit, është kështu.*** Ata (Hanefijët) e kanë konsideruar argument të pestë të ligjësimin, dhe me të ndonjëherë anashkalohet edhe kijasi, sepse (Istihsani) është lloj i llojeve të kijasit. Me fjalë tjera, është kijasë i fshehtë përball kijasit të hapur. Quhet kështu, nga shkaku se tregon përparësinë e të vepruarit me të, dhe siç thotë Bezdaviju, Imam Ebu Hanife ka qenë i shkëlqyeshëm në të vepruarit me istihsanë, saqë nxënësi i tij Muhamed bin Hasan për të ka thënë: *Shokët e tij polemizonin në çështje të krahaseve, por kur (Ebu Hanife) thoshte: Istihsani i kësaj çështje është kështu, askush nuk mund të fliste më pastaj.*

Një pjesë e madhe e dijetarëve e kanë pranuar dhe kanë vepruar me istihsanin. E ka vërtetuar Malikiju dhe Hanbelijët, kurse Imam Maliku r.a. ka thënë: Të ilustruarit me istihsanë ndonjëherë dominon mbi kijasin. Është siguruar se Maliku ka thënë: *Të zhyturin në istihsanë, për pak gjë mund ta largoj nga suneti.*³

Shafiiu e ka refuzuar të vepruarit me istihsanë. Është transmetuar në librat e usulit thënia e njohur e tij, edhe pse kjo thënie nuk është në librin e tij “Err-Risaletë”: *Kush ligjëson me istihsanë, ai ka vendosur ligj të tij (personal), që do të thotë, ligj të ri.*

Bazë e dallueshmërisë (mospajtimin) është, të sqaruarit e esencës së istihsanit. Për këtë arsye, hulumtimin tim e kam paraparë në këtë mënyrë:

- Esenca e istihsanit;
- Llojet;
- Argumenti; dhe
- Mendimet e dijetarëve për istihsanin.

Tema e parë: Esenca e istihsanit

Gjuhësisht, *istihsanë* do të thotë: “Të llogariturit dhe bindja se një çështje është e mirë”. Nuk ka papajtueshmëri në mes të dijetarëve në lejinimin e fjalës *istihsanë*⁴, pasi që kjo fjalë është përdorur në Kur’anin fisnik, si f.v., thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

الَّذِينَ يَسْتَمِعُونَ الْقَوْلَ فَيَتَّبِعُونَ أَحْسَنَهُ

“Ata të cilët e dëgjojnë fjalën dhe e pasojnë me mirësi.” (Ez-Zumer : 18)

po ashtu thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَأْمُرْ قَوْمَكَ يَأْخُذُوا بِأَحْسَنِهَا

“Urdhëroje popullin tënd që të veprojnë më të mirën (e mundshme) e saj.” (El Earaf : 145)

Është përdorur edhe në sunet, siç është transmetuar nga ibn Mes’udi:

“Atë çka e shohin muslimanët se është e mirë, edhe te Allahu është e mirë.”⁵

Është përdorur edhe në thëniet e muxhtehidëve, si f.v.:

“Është e mirë hyrja në banjë pa u përcaktuar sasia e shpenzimit të ujit.”

nuk përcaktohet koha e qëndrimit në të, po ashtu:

“Është mirë të pihet ujë pa u përcaktuar sasia e ujit.”

gjithashtu thënia e Shafijut:

“Është mirë që në kurorëzimin “mut’a” (dhurata pas shkurorëzimit) që të jetë tridhjetë dërhem.

Është mirë caktimi i “shufuas” për “shefin”, deri në tri ditë.

Është mirë që i liruari nga robëria me pagesën e tij, që pagesën ta bëjë me këste.”

Sa i përket vjedhësit ka thënë: “Nëse e lëshon dorën e majtë në vend të së djathtës, kur është i dënuar, i prehet. Kjo për shkak të kijasit me të djathtën. Në bazë të istihsanit nuk i prehet, ndërsa në bazë të kijasit i prehet (prapë) dora e djathtë.

Është mirë që të bëhet përbetimi me mus’haf”, e raste të ngjashme.⁶

Kështu pra, papajtueshmëria është në kuptimin dhe esencën e kijasit.

Istihsanë quhet ajo çka njeriu anon nga dëshirat e tij, si nga aspekti i jashtëm ashtu edhe nga kuptimi i brendshëm, edhe nëse është e papëlqyer apo e keqe te tjetri, prej çështjeve të cilat muxhtehidi e konsideron e mirë në

bazë të logjikës së tij⁷. Për këtë nuk ka papajtueshmëri në mes të dijetarëve në ndalimin e tij, sepse janë pajtuar se në fe nuk ka mendim sipas dëshirave dhe apetiteve.

Dijetarët nuk janë pajtuar rreth përcaktimit të definicionit të istihsanit.

Disa kanë thënë: ***Është argument të cilin muxhtehidi e ndjen në zemër, por nuk gjen shprehje për ta deklaruar,***⁸ që do të thotë, e ka vështirë ta shprehë dhe nuk mund të gjejë shprehje për ta paraqitur.

Ky definicion është kundërshtuar sepse pasusi “*jenkedih*”, ka kuptimin se, muxhtehidi dyshon në mes të asaj se a është argument i fortë apo iluzion dhe jo i plotë. Kjo është e papranuar, sepse ligjet e sheriatit nuk vendosen me dyshim dhe hamendje. Nëse e ka kuptimin se, në fakt ligjësimi mund të realizohet, është argument i sheriatit me të cilën duhet të veprohet, e për këtë (të dytën) nuk ka dyshim se janë të pajtimit se pranohet.

Disa kanë thënë: Istihsanë do të thotë: ***Kalimi prej argumentimit të kijasit në argumentim të kijasit tjetër më të fuqishëm, ose specifikimi i kijasit, me argument më të fuqishëm se ai.***⁹

Ky argument është kritikuar sepse nuk i përmbledh në vete të gjitha llojet e istihsanit sepse nuk përfshinë istihsanin me tekst prej Kur’anit apo sunetit, istihsanin prej ixhmait, ose prej traditës, ose për shkak të domosdoshmërisë, ose të interesit.

Kerhiju thotë: ***Istihsani është kur njeriu gjykon për një çështje dhe kalon siç ka gjykuar një i ngjashëm me të, pra në të kundërtën e gjykimit më të fuqishëm, i cili e kërkon anashkalimin e gjykimit të parë.***¹⁰

Edhe ky definicion është kritikuar sepse është i njëjtë me të kaluarit nga e përgjithshmja në të specifikuarën, nga shfuqizuesi në të shfuqizuarën, për shkak të istihsanit. Te Hanefijtë, kjo nuk quhet istihsanë. Shafiiju thotë: “Për këtë nuk kemi mospajtim, sepse pikësynimi është që istihsani të specifikojë argumentin. Ne këtë nuk e kundërshtojmë.”¹¹

Imam Maliku ka thënë: ***Istihsanë quhet, të vepruarit me argumentin më të fuqishëm ndërmjet dy argumenteve, ose marrja parasysh e interesit parcial përball argumentit të përgjithshëm.*** Kështu pra, të dhënit përparësi argumentit të përgjithshëm ndaj kijasit.

Ibn Arabij ka thënë: ***Istihsanë është anashkalimi i argumentit në bazë të rregullit të përjashtimit dhe të lehtësimit, për shkak të kundërshtimit të një argumenti kundërshtues në disa çështje***, pastaj e ka ndarë në katër lloje:

- Anashkalimi i argumentit të traditës;
- Anashkalimi i argumentit të interesit;
- Anashkalimi për të lehtësuar të vështirësuarin;
- Largimin e vështirësisë dhe zgjerimin e ngushtimit.

Ibn Ruzhdi e definon kështu: ***Është paraqitje e kijasit, i cili kijasë në gjykim është i rëndë dhe i stërmadhuar, e pastaj anashkalohet në disa vende sepse e merr kuptimin se ndikon në ligj për të specifikuar ato vende***.

Shatibiju thotë: Këto definicione janë të përafërta me njëra-tjetrën. Nëse këtë koncept e kanë Maliku dhe Ebu Hanife, kategorikisht rezulton se ata nuk kanë dalë jashtë argumenteve sepse argumentet e kushtëzojnë njëra-tjetrën dhe e specifikojnë njëra-tjetrën, siç është rasti i argumentimit të sunetit me Kur'anin. Shafiiu në esencë nuk e ka këtë qëllim. Nuk është argument të quajturit e istihsanit, si çështje e cila është risi.¹²

Ebu Hasan el Basriu ka thënë: ***Është anashkalim i një forme prej formave të ixhtihadit jo të plotë në formulim me një formë më të fuqishme se ai dhe bëhet ligj në vete nga i pari***.¹³

Është thënë ***“jo të plotë në formulim”*** që të mos merr pjesë ***“specifikimi i përgjithësimit”*** sepse forma e parë në përgjithësim përfshinë të gjitha njësitet në tekstualizim. Pasusi ***“dhe bëhet ligji në vete nga i pari”*** është formuluar në ***“dhe bëhet ligj në vete nga i pari”*** që të mos merr pjesë ***“anashkalimi i kijasit më të dobët nga kijasi më i fortë”*** sepse më i fuqishmi i dy kijaseve nuk është ligj në vete, por atëherë kur ligj i ri ligjësohet ligj në vete, atëherë quhet ***istihsanë***.

Amediu ka thënë: Nga ky definicion, rezulton se istihsani ka kuptimin: ***Kthimi nga ligji i argumentimit të veçantë nga ligji përballë tij me argumentin e ri më të fuqishëm se ai, me tekst, ixhmaë ose argument tjetër***.

Është e vërtetë se nuk shoh mospajtim thelbësor në mes të dijetarëve sa i përket istihsanit, por vetëm mospajtim shprehimor, siç e thonë një pjesë e dijetarëve analitik, si f.v., Ibn Haxhibi, Amediju, Sebkiju, Esneviju dhe Shevkaniju¹⁴. Shprehjet e tyre janë si në vijim: E vërteta është se nuk mund të realizohet istihsani në atë që nuk janë pajtuar (dijetarët), por në realitet mospajtimi është në shprehjet e traditës, ose interesit i cili është i vlefshëm

për specifikimin e argumentit të përgjithshëm, që do të thotë se istihani i përngjan asaj që juristët e quajnë *drejtim në frymën kushtetuese dhe rregullave parimore të përgjithshme*.

Definicionin e istihsanit e rrumbullakojmë në dy çështje:

1. Prioriteti i kijasit të fshehtë ndaj kijasit të qartë, në bazë të argumentimit;
2. Përgjithësimi i çështjeve parciale praj atyre të përgjithshme, duke u bazuar në ndonjë argument të posaçëm i cili e kërkon atë. Këtë do ta sqaroj dhe do ta ilustroj me shembuj në temën *llojet e istihsanit*.

Dallimi në mes të kijasit, istihsanit dhe parimit të interesit

Siç e kemi mësuar, **kijasi** është bartja e çështjes së patekstualizuar në dispozitë të sheriatit në çështje të tekstualizuar në dispozitën e tij, për shkak të pikëpërbashkësisë së arsyes së dispozitës. Te ky rast, çështja themelohet me tekst ose me ixhmaë, e pastaj ajo çështje bartet tek një rast tjetër në ligjësim, për shkak të pikëpërbashkësisë së arsyes në të dy rastet. *Shembull:* Kijasi i verës me pije alkoolike, dhe ndalimi i tyre me arsyetimin se dehja ekziston në të dy rastet.

Sa i përket istihsanit, siç e kemi mësuar, gjithashtu është anashkalimi (tejkalimi) i ligjit, duke e argumentuar rastin e ngjashëm me argument më të fuqishëm, si f.v., anashkalimi prej tekstit të përgjithshëm ose kijasit me tekst të posaçëm (parcial) ose në kijasin e fshehtë për shkak të arsyeshmërisë më të thuktë e cila është fshehur nga mendja sepse në këtë ruhet interesi ose largohet dëmi. *Shembull:* Lejimi i aktit të paradhënies prodhuese edhe pse e kontraktuara ende nuk posedohet në momentin e kontraktimit të kontratës.

Sa i përket parimit të interesit, të cilën do ta sqarojmë më vonë, është rotacioni i ekzistimit të atributit të përshtatshëm për t'u ligjësuar ligji, por që Ligjvënësi as nuk e ka shfuqizuar dhe as nuk e ka fuqizuar, që do të thotë se, për çështjen për të cilën bëhet angazhimi për ta ligjësuar nuk ka as tekst, as ixhmaë, as kijasë. *Shembull:* Tubimi i Kur'anit në kohën e Ebu Bekrit r.a. dhe Uthmanit r.a. Nga kjo kuptohet se:

- **Kijasi** aplikohet në ndodhitë të cilat kanë ngjashmëri, në tekst ose në ixhmaë;
- **Istihsani** aplikohet në çështjet të cilat kanë ngjashmëri, por që përjashtohet nga ligji për shkak të argumentit i cili e kërkon atë;
- **Parimi i interesit** aplikohet në ndodhi e cila nuk ka ndonjë ngjashmëri të ndonjë ligji sheriatik me të cilin mund të analogohet, por që ligji përpilohet që nga baza fillestare.¹⁵

Tema e dytë: Llojet e istihsanit

Edhe kijasi edhe istihساني janë dylojësh:

Kijasi i qartë është dylojësh:

1. Kijasi me ndikim të dobët përballë kijasit me ndikim të fuqishëm, i cili (kijasë) është istihساني; dhe
2. Kijasi të cilit i paraqitet plogështia, i fshihet ndikimi dhe fuqia, për shkak se i bashkëngjitet element i fshehur i cili ndikon në ligj andaj i jepet përparësi të kundërtës së saj.¹⁶

Istihساني është dylojësh, të cilat janë të kundërta me llojet e kijasit:

1. Istihساني me ndikim të fuqishëm, edhe pse i fshehur;
2. Istihساني të cilit i paraqitet ndikim i tij dhe i fshihet pavlefshmëria pas analizimit të saj.¹⁷

Prioriteti në mes të kijasit dhe istihsanit bëhet në bazë të fuqisë së ndikimit dhe jo në bazë të fshehjes dhe qartësisë.

Kur të forcohet ndikimi i kijasit, i jepet përparësi ndaj istihsanit. E gjithë kjo realizohet kur të kundërshtojnë njëra-tjetrën, kështu që i jepet përparësi llojit të parë të istihsanit kundrejt llojit të parë të kijasit dhe i jepet përparësi llojit të dytë të kijasit kundrejt llojit të dytë të istihsanit.

Shembull i të parës: Jarga e shpendëve të egër mishngrënës, si f.v., sokoli, shqiponja, orli, sa i përket dispozitës së pastërtisë së jargëve prej tyre, kijasi dhe istihساني kundërshtohen në mes vete:

Sipas kijasit është i papastër, duke u analoguar me jargët e kafshëve të egra mishngrënëse, siç janë, tigri, ujku, luani, leopardi, sepse dispozita është arsyetuar në bazë të ngrënies së mishit dhe që të gjitha janë mishngrënëse. Jarga e secilës prej tyre është e papastër, për shkak të përzierjes në fyt dhe mbetjeve nga mishi, të cilat janë të papastra.

Sa i përket istihsanit, jarga e tyre është e pastër, analog me njeriun, sepse asnjëri prej tyre nuk është shkoqës i kafshëve me dhëmbë, kështu që i jepet përparësi istihsanit, sepse është i dobët ndikimi i kijasit në të, e ajo është të përzierit e lëngut të fytit të papastër në ujin të cilin e lëshon jarga e egërsirave, përderisa kthetrat e shpendëve të egër janë të kundërta (me sqep shkoqës), sepse ato pinë ujë me sqep, e sqepi është koc i pastër, sepse është i terur dhe nuk ka lagështi. Përderisa, koci i cofëtinës nuk është i papastër, atëherë si mund të jetë i papastër koci i të gjallës?. Nuk bëhet i papastër uji me takimin me të (sqepit). Kështu që, është i pastër sikurse jarga e njeriut,

për shkak të mungesës së arsyeshmërisë së papastërtisë, e ajo është lagështia e papastër në mjetin e pirjes së ujit. Vetëm se, duhet ditur se kjo është mekruh sepse shpendët shkoqës si krijesa nuk dalin jashtë kornizës së cofëtines dhe papastërtisë, dhe me këtë na del se ndikimi i kijasit të fshehtë është më i fuqishëm se ndikimi i kijasit të qartë.¹⁸

Shembull i rastit të dytë: Sexhdeja e leximit është vaxhib gjatë leximit të saj në namaz. Sa i përket kryerjes së saj me rukuë, me nijet të sexhdes, kundërshtohet kijasi me istihsanin:

Sipas kijasit: Lejohet kryerja e kësaj sexhde “me rukuë në namaz”, me nijet të “sexhdes së leximit” sepse qëllimi prej sexhdes është tregueshmëria e madhësisë së Allahut dhe nënshtrimi ndaj Zotit, për të kundërshtuar kryelartët. Ky kuptim realizohet edhe me rukuë, sepse në mes tyre shfaqet qëllimi i njëjtë. Për këtë arsye, është përdorur rukuja në vend të sexhdes në Kur’anin fisnik, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë **“dhe nxitoi në rukuë”** që do të thotë, **nxitoi dhe ra në sexhde**. Ky kijasë është i qartë, por që i është fshehur vlefshmëria, mirëpo në të ka paqartësi të qartë sepse do të nënkuptonte vlefshmërinë e kryerjes së detyrës së urdhëruar me diçka çka nuk është urdhëruar dhe vlefshmërinë e të vepruarit me fjalë alegorike kur ekziston mundësia e të vepruarit me fjalën e drejtë (joalegorike) dhe kur nuk ekziston pamundësia.

Sipas istihsanit, kjo nuk lejohet, sepse Ligjvënësi ka urdhëruar për sexhde, e sexhdeja e leximit nuk kryhet me rukuë, pasi që kijasi është me sexhden e namazit dhe nuk mund ta zëvendësoj rukuja e namazit. Kjo është kijasë i qartë, mirëpo, për të vepruar me të e ka një të metë të fshehtë, sepse është kijasë me dallueshmëri, sepse secila prej tyre, edhe rukuja edhe sexhdeja në namaz kërkohen që të kryhen për qëllime të veçanta. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا ارْكَعُوا وَاسْجُدُوا وَعْبُدُوا رَبَّكُمْ وَأَفْعَلُوا الْخَيْرَ لَعَلَّكُمْ

تُفْلِحُونَ ﴿٧٧﴾

“O ju të cilët keni besuar, bini në ruku dhe në sexhde.” (El Haxh : 77)

Nuk lejohet që kryerja e njëres ta zëvendësoj kryerjen e tjetrës. Sa i përket sexhdes së leximit, nuk e ka qëllim në vetvete, por qëllimi i konceptit të saj është shprehja e madhërimit. E kjo e realizon atë që Ligjvënësi e quan adhurim, e ajo është rukuja e namazit, dhe kryhet vetëm me rënie në sexhde, ashtu siç kryhet detyra e pastrimit në namaz vetëm me pastrimin për diçka

tjetër, si f.v., leximi i Kur'anit. Në këtë rast i kemi dhënë përparësi kijasit mbi istihsanit.

Varësisht prej argumentit me të cilën përpilohet istihsani, ai ndahet edhe në formë tjetër me lloje të cilat janë:

- Istihsani me tekst;
- Istihsani me ixhmaë;
- Istihsani për shkak të domosdoshmërisë;
- Istihsani i kijasit të fshehtë;
- Istihsani i traditës;
- Istihsani i interesit të përgjithshëm.

Istihsani me tekst (Kur'an dhe Sunet)

Tekst quhet teksti i cili është ose prej Kur'anit fisnik ose prej sunetit të pastër. Kuptimi i kësaj është që, për një çështje që vjen në tekst (Kur'an dhe sunet), i cili ligjëson një ligj në kundërshtim me ligjin e përgjithshëm me argument të përgjithshëm (Kur'an dhe sunet). Në lidhje me këtë lloj të istihsanit, Gazaliu thotë: *Kjo është diçka që nuk urrehet, por mospranimi rezulton prej fjalës dhe specifikim i këtij lloji me argumentin e ashtuquajtur istihsanë nga argumentet tjera (përpos Kur'anit dhe sunetit).*¹⁹

Shembull i istihsanit me Kur'an: Testamenti, në bazë të kijasit është i papranueshëm, sepse është pronësim para shpronësimit të pasurisë, që ndodhë (shpronësimi) vetëm pas vdekjes, mirëpo kjo është përjashtuar nga rregulli i përgjithshëm me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

مَنْ بَعْدَ وَصِيَّةٍ يُوصِيَنَّ بِهَا أَوْ دَيْنٍ

“...pas testamentit i cili testamentohet ose (pas larjes) borxhit.” (En Nisaë : 12)

Shembull tjetër: Pasuria ime do të jepet sadaka ose unë e kam për detyrë që pasurinë time ta jap sadaka, e në bazë të kijasit, duhet të jepet e gjithë pasuria sadaka, mirëpo në bazë të istihsanit, duhet të jepet pjesa e zekatit, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً

“Merr prej pasurisë së tyre sadakanë (zekatin).” (Et Tevbe : 103)

Shembull i istihsanit me sunet: Ligji për vazhdimin e agjërimit edhe pas ngrënies dhe pirjes me harresë. Në bazë të kijasit, pra parimit të përgjithshëm, agjërimi priset për shkak të ngrënies, por në bazë të hadithit të Muhamedit s.a.v.s është përjashtuar nga ky rregull.:

“Kush ha ose pi me harresë, mos ta prish agjërimin, sepse është furnizim me të cilin e ka furnizuar Allahu.”

Në një transmetim tjetër:

“Kush harron derisa është agjërueshëm dhe ha ose pi, le ta plotësojë agjërimin e tij, sepse Allahu është Ai i Cili e ka ushqyer me të ngrënë dhe me të pirë.”²⁰

Shembull tjetër është ai i lejimit të kontratës së paradhënies së prodhimtarisë. Në bazë të kijasit, pra të argumentit të përgjithshëm, nuk lejohet, sepse është blerje inekzistente, sepse peygamberi s.a.v.s. e ka

ndaluar të shitblehet malli inekzistent (atë çka njeriu nuk e ka në disponim), mirëpo kjo është përjashtuar me argumentin e posaçëm, e ai argument është thënia e Muhamedit s.a.v.s.:

“Kush huazon hurma, le të huazoj në masë të caktuar, në peshë dhe sasi të caktuar, deri në një afat të caktuar.”²¹

Malikijët, sipas një transmetimi të tyre e konsiderojnë: Të vepruarit me argumentin më të fuqishëm prej dy argumenteve²², duke e lejuar shitblerjen **“Urja”** (shitblerja “urja” quhet shitblerja e hurmave të njoma me ato të thata në shumën prej 5 ose më pak se 5 evsak , që është e barabartë me 653 kg). Pasi që me lejimin e kësaj shitblerje kemi lehtësim nga vështirësia. Në bazë të kijasit, kjo shitblerje nuk lejohet, sepse peygamberi s.a.v.s. e ka ndaluar shitblerjen e hurmave të njoma me të thata, apo farave të njoma me të thata,²³ mirëpo e ka lejuar me këtë tekst hadithor, sepse peygamberi s.a.v.s. ka bërë lehtësim në shitblerjen **“urja”**, pra që të shitblehet sasia (e llojit të njëjtë).²⁴ Hanefijët këtë shitblerje e kanë kundërshtuar duke e përkufizuar shitblerjen në llojin e dhuratës (jo të shitblerjes).

Istihسانی me ixhmaë

Kjo realizohet kur muxhtehidët japin fetva për një çështje, e cila është në kundërshtim me bazën e cila është e njëjtë me të, ose kur heshtin me veprimtarinë e njerëzve pa i kundërshtuar. *Shembull:* Ixhmai i dijetarëve për lejimin e kontratës “**istisnaë**” (është atëherë kur një person lidh kontratë me një prodhues për t’ia prodhuar një mjet të ngjashëm me një mjet tjetër me një çmim të caktuar). **Në bazë të kijasit**, kjo kontratë është e pavlefshme, sepse e kontraktuara në çastin e kontraktimit është inekzistente, mirëpo është lejuar një veprimtari e tillë, për shkak se në të gjitha kohërat është vepruar një kontraktim i tillë, dhe dijetarët nuk e kanë kundërshtuar, e atëherë është themeluar ky ixhmaë dhe është anashkaluar kijasi, pasi që ka qenë nevojë e njerëzve që të veprohet ashtu, dhe kjo është pranuar për të larguar vështirësinë nga ta.²⁵

Istihsani me traditë (zakon)

Pagesa për larje në banjë, pa u përcaktuar sasia e shpenzimit të ujit dhe kohës së qëndrimit në të. **Në bazë të kijasit**, kjo nuk lejohet, sepse akti për pastrim në banjë, nuk e përcakton as shpenzimin e sasisë së ujit dhe as kohën e qëndrimit, e cila është vagë e cila i pengon mosmarrëveshjet, për këtë arsye, nuk lejohet kontrata për të panjohurën (të papërcaktuarën). Panjohuria (papërcaktimi) e bën të pavlefshëm aktin e kontratës, mirëpo **istihsani** e vërteton të kundërtën e kësaj, duke u mbështetur në atë se tradita e ka lejuar në çdo kohë, dhe e ka lënë në dorë të kontraktuesve për shkak të përfitimit të të dy palëve dhe në mënyrë që të mos ua vështirësojë gjendjen, si dhe duke e pasur parasysh nevojën e njerëzve për të vepruar me të.

Shembull tjetër: Lejimi i vakfit për pasuri të luajtshme, e cila mund të bartet prej pasurisë së paluajtshme, e kjo (lejimi) sipas mendimit të Muhamed bin Hasanit. **Në bazë të kijasit** kjo nuk lejohet, sepse sendet e luajtshme mund të shpenzohen. Dihet se bazë e sendit për t'u lënë vakëf është që të jetë e përgjithmonshme dhe nuk lejohet vakfi në ta, mirëpo është lejuar në bazë të istihsanit zakonor (traditës).

Istihsani prej domosdoshmërisë

Është atëherë kur ekziston një domosdoshmëri dhe atë domosdoshmëri (nevojë) muxhtehidi (eksperti i usulit) e vendos në praktikë dhe e anashkalon kijasin. *Shembull*: Pastrimi i puseve dhe liqeneve, në të cilat bie ndonjë mbeturinë. **Në bazë të kijasit**, ato nuk mund të pastrohen me nxjerrjen e ujit apo të një pjese të ujit, sepse nxjerrja e një pjese të ujit e cila gjendet në pus apo liqe, nuk ndikon në pastrimin e pjesës tjetër të ujit, ndërsa nxjerrja e tërësishme e ujit nuk ka kurrfarë vlere që ta bëjë ujin të pastër nga burimi i ujit përsëri, pasi që papastërtia ngjitet në anësore apo në fund të pusit apo liqenit, pra në vendin ku ka qenë uji. Po ashtu edhe ena bëhet e papastër, pasi që përfshihet me ujin e papastër, dhe ajo vazhdon të mbetet e papastër, mirëpo, dijetarët e kanë marrë më të mirën e mundshme (istihsanin), dhe e kanë anashkaluar të vepruarit me kijasë, kështu që kanë gjykuar për pastërtinë e ujit, pasi që të hiqet një sasi e caktuar e ujit, për shkak se domosdoshmëria e kërkon atë.²⁶

Istihسانی me kijasın e fshehtë

Është forma e parë, të cilën e kemi treguar në pika të shkurtra të definicioni i kijasit. E kam sqaruar të shembulli në temën e ndarjes së parë të istihsanit, pra, të shpendët e egër mishngrënës, dhe ajo se, veprohet çdo herë kur të kemi të bëjmë me dy llojet e kijasit: **Kijasi i qartë**, kur arsyeshmëria shihet qartë. **Kijasi i fshehtë**, për shkak të arsyeshmërisë së fshehtë.

Shembull tjetër është vakfi i plantacioneve të pemëve (agronome), në të cilin janë dy lloje të kijasit: **Kijasi i qartë**, sepse ky lloj vakfi i përngjanë shitblerjes, sepse secili prej tyre e merr atë çka i takon nga pronësimi, dhe nuk merr pjesë rruga, pirja e ujit, përroska, pra, e drejta për të shfrytëzuar rrugën për kalim, vetëm në rast se e nënvizon vakëflënësi, sikurse në rastin e shitblerjes. **Kijasi i fshehtë**: Vakfi i përngjan qiradhënies, ku secili prej tyre e ka të drejtën vetëm të shfrytëzimit të pjesëve të tyre. Në bazë të kësaj, bën pjesë e drejta e ujit, e drejta e rrugës dhe të drejtat tjera në vakëf, edhe nëse vakëflënësi nuk e ka nënvizuar, siç është rasti me dhënie me qira. Kështu që, muxhtehidi i jep përparësi kijasit të dytë (të fshehtë) ndaj kijasit të parë (kijasit të qartë), sepse qëllimi i vakfit të tillë është vetëm shfrytëzimi dhe në të nuk hyn e drejta e ujit dhe e rrugës në vakëfin e asaj toke nëse kjo nuk nënvizohet, e kjo është **istihسانی**.

Istihsani i interesit

Është brenda kornizës së formës së dytë të cilën e kemi përmendur te definicioni i istihsanit, te i cili e përfundova definicionin.

Shembull: Vlefshmëria e testamentit për çështje të dobishme, i atij i cili është mendjelehtë. **Në bazë të kijasit**, pra të rregullit të përgjithshëm: Është i pavlefshëm bamirësia (donacioni) e atij i cili nuk ka imunitet, sepse ai është i paqartë në pasurinë e tij, mirëpo, **në bazë të istihsanit**, lejohen donacionet e tij në bamirësi, sepse qëllimi i mospranimit për raste të tjera është që atij t'i sigurohet pasuria dhe të mos i humb, ashtu që të mos bëhet vegël e tjetrit. Testamenti në bamirësi nuk bie ndesh me këtë qëllim, sepse nuk rezulton shpronësim të menjëhershëm, por vetëm pas vdekjes së tij. Kështu që bëhet përjashtim te rasti i testamentit duke e anashkaluar rregullën e përgjithshme, për shkak (në dobi) të interesit parcial, e ajo është të fituarit e shpërblimit dhe sjelljen e dobisë prej tij, duke mos e dëmtuar aspak derisa ai është në jetë. E pra, ky është **istihsanë**.

Shembull tjetër: Dhënia e zekatit për pasardhësit Hashimit. **Në bazë të kijasit**, kjo është e papranuar, siç është vërtetuar nga pejgamberi s.a.v.s., mirëpo Ebu Hanife në kohën e tij, **në bazë të istihsanit** e ka lejuar që t'u jepet zekati, për t'i siguruar ata nga humbja dhe për t'ua përmirësuar gjendjen e tyre.²⁷

Shembull tjetër: Dënimi për porosi të prodhimeve industriale. **Në bazë të kijasit**, nuk lejohet një dënim i tillë, sepse ato janë të sigurt në bazë të kontratës së qiradhënies dhe nuk dënohen për atë që prishet në duart e tyre, përpos nëse e tejkalojnë dhe janë vetshkaktar të prishjes për atë që e kanë në përgjegjësi t'i ruajnë, mirëpo, **në bazë të istihsanit**, duhet të dënohen, për të parandaluar moskujdesin e tyre dhe sigurimin e pasurisë së njerëzve. Kështu kanë dhënë fetva dy nxënësit e Ebu Hanifes, sepse e kanë pasur parasysh se mund të ndodhin mashtrime dhe kësioj shkelet (abuzohet) e drejta pronësore.

Malikijë, sipas një transmetimi prej tyre, në çështjen e të vepruarit me interesin parcial në kundërshtim me rregullin e përgjithshëm kanë sjellë shumë shembuj, e prej tyre "huaja", e cila në esencë është kamatë, sepse është dërm me dërm për një kohë të caktuar, mirëpo është lejuar si formë e tolerancës, si butësi dhe që t'u krijojë hapësirë nevojtarëve, sepse po të mbetej në bazë, do të ishte e ndaluar, e kjo do të shkaktonte vështirësi për njerëzit.

Shembull tjetër: Zbulimi i pjesëve të turpshme për mjekim është i lejuar, edhe pse në bazë të argumentit të përgjithshëm, për shkak se është i dëmshëm dhe sjell fatkeqësi, është i ndaluar.

Shembull tjetër: Në stuhi me shi, lejohet bashkimi i namazit të akshamit me të jacisë.

- Lejohet bashkimi i namazeve për udhëtarin;
- shkurtimi i namazit dhe mosagjërimi për udhëtarin që është në udhëtim të gjatë;
- si dhe lejimi i namazit të frikës dhe të gjitha lehtësimet tjera.

Baza esenciale e të gjitha rasteve që i përmendëm, qëndron në sigurimin e interesit ose largimin e vështirësisë dhe dëmit, përball (të cilat janë në kundërshtim) me argumentin e përgjithshëm i cili nuk i lejon ato lehtësime.²⁸

Kjo dhe... Profesori Xhelil Mustafa Zarka, në librin e tij “Hyrje në fikh” e ka kritikuar ndarjen tradicionale të istihsanit. Istihsanin e tekstit dhe të ixhmait, në të vërtetë e llogaritë si istihsanë të Ligjvënësit. Për këtë nuk ka çka të debatohet, por duhet debatuar për istihsanin e fikhut, i prodhuar, i cili aplikohet në tekstet e Ligjvënësit dhe analogohen me ta. Atëherë *mirë* (istihsan) është të ndalemi aty dhe ta anashkalojmë dispozitën prej kijasit, pasi që këtë e kërkon qëllimi i Ligjvënësit dhe qëllimet bazë të shariatit dhe kjo përfshinë vetëm dy lloje:

1. Istihsanin e kijasit; dhe
2. Istihsanin e domosdoshmërisë.

Ky është një orientim i shëndoshë dhe analizë e thellë dhe e qartë, vetëm se e vërteta është se Hanefijtë dhe të tjerët e zgjerojnë sferën e istihsanit në të gjitha llojet tjera të cilat i përmendëm. Sipas mendimit tim, çështja ndryshon varësisht prej planprogramit të analizuesit. Nëse është fjala për ixhtihadin, duhet shkuar në drejtimin siç e parasheh profesor Zarka, ndërsa nëse është fjala për analizë të thellë të formave të istihsanit, siç është istihsani në vetvete, është istihsanë i përjashtuar nga e përgjithshmja dhe kalon në planprogramin të cilin e sqaruar dhe në të fukahatë i sqarojnë teoritë e tyre sa më të qarta.

E vërteta është se, nëse unë do t’i vështroja të gjitha llojet e istihsanit, nuk do të kisha hasur në atë që quhet se istihsani është argument i pavarur në vetvete, por bën pjesë në burimet tjera, siç janë, Kur’ani, suneti, kijasi, dhe interesi, por më së shumti në të bën pjesë **interesi**.²⁹

Tema e tretë: Argumentimi i istihsanit dhe mendimet e dijetarëve për të (istihsanin)

Kur e kam sqaruar konceptin e istihsanit, tregova se nuk ka istihsanë për të cilin janë pajtuar dijetarët (unanimisht), siç e kanë thënë këtë një pjesë e madhe e analitikëve, mirëpo, unë, para se të arrij te ky rezultat, dëshiroj të sqaroj për argumentet e atyre të cilët e pranojnë istihsanin dhe **argumentet e atyre të cilët nuk e pranojnë.**

Hanefijtë, Hanbelijtë dhe Malikijtë, thonë se, **istihsani është argument i sheriatit.**³⁰

Disa dijetarë nuk e pranojnë, e prej tyre, Shafijitë, dhahirijtë, dhe muëtezilët dhe dijetarët kabit të shiitëve.³¹

Shafiiu ka thënë: “Kush gjykon me istihsan, ka shpikur ligj në vete.” (Për këtë thënie) Ruvenaiju ka thënë: “Kuptimi i kësaj është për atë i cili gjykon prej vetes së tij dhe jo prej sheriatit.” Shafiiu i ka kushtuar vëmendje të posaçme (istihsanit) në librin e tij “El Um” për të mospranuar istihsanin dhe aty thotë: “Istihsani është i pavlefshëm.”³² Në librin “Risale”³³ ka thënë: “Istihsani është kënaqje e epshit. Nëse ndonjëri do të lejonte gjykimin në fe me istihsanë, ai do të lejonte që të gjykohej me mendjet e tyre dhe jo me logjikën e dijes, do të lejohej që në fe të ligjësohej për çdo temë dhe secili të ligjësonte ligj në vete.”

Ibn Hazmi ka thënë: “E vërteta është e vërtetë, edhe nëse njerëzit e urrejnë. E pavërteta është e pavërtetë, edhe nëse njerëzit e konsiderojnë të mirë. Është vërtetuar se istihsani është pasim i epshit, ligj i dëshirave dhe i humbjes, kërkojmë nga Allahu mbrojtje nga to.”

Nga këto fraza të shkurtra, mund t’i kuptojmë argumentet e mohuesve të istihsanit, të cilat janë:³⁴

1. Nuk lejohet ligjësimi pos me tekst, ose me atë çka analogohet me tekst, sepse çka kalon prej kësaj është ligjësim i epshit dhe i dëshirave. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَأَنِ احْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَاحْذَرْهُمْ

“Dhe gjyko në mes tyre me atë që ta ka zbritur Allahu dhe mos i paso epshet e tyre.” (El Maide : 49)

2. Baza e istihsanit është mendja, në të barazohen i dituri dhe injoranti. Nëse për secilën çështje do të lejohej istihsani, do të lejohej që njeriu të ligjësoj ligj të ri në vete.

Ata të cilët e pranojnë istihsanin argumentohen me argumentet si në vijim:

1. Të vepruarit me të, është lehtësim i vështirësisë, e cila është bazë themelore në fe. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

يُرِيدُ اللَّهُ بِكُمْ الْيُسْرَ وَلَا يُرِيدُ بِكُمْ الْعُسْرَ

“Allahu për ju dëshiron lehtësim dhe nuk dëshiron për ju vështirësim.” (El Bekare : 185)

Në një ajet tjetër, e preferon të vepruarit me më të mirën, kur thotë:

وَاتَّبِعُوا أَحْسَنَ مَا أُنْزِلَ إِلَيْكُمْ مِنْ رَبِّكُمْ

“Dhe pasojeni më të mirën (ahsene) e cila është zbritur për ju prej Zotit tuaj.” (Ez Zumer : 55)

Dhe thënia e Ibni Mes’udit r.a.: Atë që muslimanët e shohin të mirë, ajo edhe tek Allahu është e mirë.

2. Me argumente me të cilat janë pajtuar për të, është vendosur që të jetë burim, sepse, ose vendoset prej ndonjë gjurmimi, si f.v., paradhënia e prodhimit, ose qiradhënia, ose mosprishja e agjërimit nga ngrënia me harresë, ose nëpërmjet ixhmait, sikurse kontrata për mallin e paprodhuar, ose nëpërmjet domosdoshmërisë si f.v., pastrimi i liqeneve dhe puseve pas rënies së papastërtive në ta, ose nëpërmjet kijasit të fshehtë, ose nëpërmjet traditës, si përбетimi sipas traditës, ose nëpërmjet interesit, si dënimi i qiramarrësit (për dëmtim).³⁵

Vërejtjet

1. Duke bërë krahasimin në mes të argumenteve të mohuesve dhe pranuesve të istihsanit, themi se nuk ka ndonjë pikë të përbashkët në të cilën e kundërshtojnë njëra-tjetrën. Shafiiu r.a., i cili nuk e pranon istihsanin, ai (istihsan) është çka ligjësohet vetëm me mendje dhe mendim absolutisht të lirë, e cila anon nga dëshira dhe epshi, pa u bazuar në argument sheriatik.

Hanefijtë dhe pasuesit pas tij nuk e thonë istihsanin në këtë koncept.

Bezdaviju ka thënë: “Ebu Hanife, Zoti e pastë mëshiruar, është më i dituri dhe më i kujdesshmi për të thënë diçka në fe sipas dëshirës ose për të vepruar me atë çka është më e mira e bazuar me argument të sheriatit.³⁶ E vërteta, siç kemi thënë, ka të bëjë me atë se, ata nuk janë pajtuar vetëm nga aspekti i tekstit dhe asaj çka është në etimologji, ndërsa nuk ka të bëjë me aspektin terminologjik.”

Kafali, njëri prej dijetarëve Shafiijë ka thënë: “Nëse me istihsanë, qëllimi është ajo çka argumentohet me argument të sheriatit, kjo është e mirë, sepse qëndron argumenti në të, e këtë nuk e mohon askush dhe e pranojmë. Por, nëse është ajo çka krijohet si ide, për të konsideruar diçka të keqe në vete dhe për të konsideruar diçka të mirë në vete, pa e argumentuar me diçka që është e argumentuar me bazën apo me një ngjarje të ngjashme të argumentuar, atëherë kjo është e ndaluar, dhe mendimi (për ndalim) është për të.”³⁷

Pas tij, këtë koncept e ka replikuar Ibn Sem’ani i cili ka thënë:³⁸ “Nëse istihsani është ajo që njeriu e konsideron *të mirë* pa pasur argument, kjo është e pavlefshme. (E këtë) Askush nuk e thotë kështu.” Pastaj e cek se, mospajtimi është vetëm mospajtim gjuhësor, dhe thotë: Interpretimi i istihsanit për diçka që është jo e mirë, e këtë nuk e thotë askush, ndërsa, interpretimi se istihsani është kalimi prej një argumenti në një argument më të fuqishëm, e këtë nuk e mohon askush.

2. Istihsani nuk përkufizohet vetëm me kijasin e fshehtë përball kijasit të qartë, por mund të jetë me tekst, me ixhmaë ose për shkak të domosdoshmërisë dhe rasteve të ngjashme të cilat i kemi sqaruar te llojet e tij. Ndonjëherë istihsani nuk qëllon përball kijasit të qartë, por mund të jetë argument i përgjithshëm apo parim i tërësishëm. Dallues i rasteve të tij është siç e tregojnë Malikijtë: ***Istihsani është të vepruarit me argumentin më të fuqishëm të të dy argumenteve.*** Istihsani më së shumti mbështetet në

parimin e interesit, e ai është istihsani i parimit të interesit, për të cilin kanë thënë Malikijtë.

3. Shatibiu thotë: “Istihsani nuk del jashtë kornizës së argumenteve, por është vështrim në atë që e kërkon dhe e imponon argumenti. Kështu pra, istihsani nuk është burim i pavarur prej argumenteve të sheriatit.”

4. Shevkaniu thotë:³⁹ “Istihsani, si hulumtim në vete, në esencë nuk ka vlerë, sepse nëse kthehet në argumentimet e mëparshme, quhet përsëritje e argumentit, nëse është jashtë argumenteve të mëparshme, atëherë nuk ka çka të ligjësohet me të, por është diçka e cila thuret për sheriatin dhe e cila nuk ka ndonjë ndikim të veçantë dhe e cila kundërshtohet me argumentet tjera.”

Fusnotat:

1. “Irshadul Fuhulë”.
“El Ihkam lil Amedij”.
“Usulu Shafij”.
“Sherhul Udadi”.
2. Shiko “Risaletu Tufi fi mesalihu mursel” dhe komentin rreth saj.
3. “El Iëtisam li Shatibij”.
4. “El-Ihkam lil Amedij”.
“Sherhul Esnefij”.
“Usulus-Sarhasiju”.
5. Nga Ibni Abasi transmeton imam Ahmedi por në “Kitabus-Suneti” dhe jo në “Musnedin” e tij.
6. “Sherhul Mehalij”.
“Gajetul Vusul”.
“Usulus-Sarhasiju”.
7. “El Mustesfa” e Gazaliut.
8. “El Mustesfa”.
“El Amedij”.
“El Esnevij”.
“Irshadul Fuhul”.
“El-Lema li-Shijraziju”.
“El-Med-hal ila medhhebi Ahmed”.
“Gajetul Vusul”.
9. “Keshful Esrar alel usul”, el Bezdeviju.
“Sherhul Udadi alel muhtesar el muntehi”.
“Gajetul Vusul”.
10. “Keshful Esrarë”, Ibid.
11. “El Esneviju”.
12. “El-Muvafekat li Shatibij”.
“El-Iëtisam”.
13. “El-Amediju”.
“El-Esneviju”.
“El-Ibhaxh”.
14. “El-Amediju”.
“El Esneviju”.
“Irsahdul Fuhul li Shevkaniju”.
“Gajetul vusul – Sherh lubhul usul lil Ensariju”.
“Sherhul Udadi alel muhtesar el muntehij”.
15. “El-Med-hal ila medhhebul Imam Ahmed”.
“Usulus-Sarhasiju”.
“El Mebadiul ameti lil fikih lil Hudarij”.
“Tarihul Fikhul-Islamij”, prof. dr. Muhamed Jusuf Musa.

16. “Keshful Esrarë”.

“Muslimuth-thubut”.

“Usulus-Sarhasiju”.

“Mer’etil Usul – sherh merekatul vusul”.

“Et-Tevdijh alet-Tenkijh”.

“Usulul Fikh lil-Hudarij”.

17. “Et-Tekrijr alet-Tehbirë”.

“Fevatihu Rahmut”.

“Muslimuth-Thubut”.

18. “Et-Tekrirë vet-Tehbirë”, “Sherhut-Tehrirë li Ibni Emirë li Ibni Emirë el Haxh”.

“Usulus-Sarhasiju”.

19. “El-Mustesfa”.

20. Transmetimin e parë e ka transemtuar Tirmidhiju nga hadithi i Ebi Hurejretes.

Transmetimin e dytë e ka transemtuar Buhariju, Muslimi dhe Ebi Davudi nga hadithi i Ebi Hurejres në librin “Xhamiul Usul”, 7/197 e më pas.

21. E kemi treguar regjistrimin e këtij hadithi.

22. “El-Muvafekat”, 4/207.

23. Hadithi nga Ahmed. Autorët e “Suneneve” nga Sead bin Ebi Vekasi

24. E ka regjistruar Buhariu dhe Muslimi nga Ebi Hurejre se pejgamberi s.a.v.s. e ka lejuar shitblerjen e llojit “urjan” nëse sasia është më pak se pesë evsak të hurmave ose në pesë (“Subules-selam”).

1 evsak = 40 saa, 5 evsak = 253 kg (2 kintarë e gjysmë).

25. “Usulus-Sarhasiji”, 2/203.

26. Hanefijtë thonë: Nëse në një bunar bie miu ose zog u e të ngjashme dhe aty ngordh.

Hiqet ujë në sasi prej 20 kovave deri në 30, varësisht se a është kova e vogël apo e madhe, pasi të hiqet miu. Nëse në bunar bie pëllumb e të ngjashme, si pula, hutat dhe macet, atëherë hiqen 40 kova.

Nëse në bunar ngordhë dele ose qenë ose njeri, hiqet i tërë uji.

Nëse në bunar bie kafsha dhe fryhet, hiqet i tërë uji, pa marrë parasysh a është e vogël apo e madhe, për shkak të shpërndarjes në të gjithë ujin (“El Hidaje” dhe “El-Fet’hul Kadijr”, 1/68-74).

27. Transmeton Muslimi nga Abdul Mutalib bin Rebiati bin el Harithi dhe po ashtu vjen në formulim tjetër. Nuk lejohet as për Muhamedin dhe as për familjen e Muhamedit, por ajo është për njerëzit.

Në transmetimin e Muslimit thuhet: Sadakaja nuk lejohet për ne, por udhëheqësit të popullit i emëruar prej tyre (“Subules-Selam”, 2/147; “Xhemul fevaid”, 1/290).

28. “El-Muvafekat lish-Shatibij”, 4/207.

29. Ligjëratat e profesorit tonë, shejhut Muhamed Zafzaf i sektorit të doktoraturës në universitetin e Kajros. Fakulteti Juridik 3, në argumentet për të cilat dijetarët nuk janë pajtuar.

30. “El-Med-hal ila medhheb Ahmed”, 135.

“Revdatu Nadhir”.

“El-Ijtisam”.

31. “El Mebadiul ameti lil-fekh- el Xhaferij”, 298.
“Usulul Istinbat”, 264.
“El-Usulul ameti”, 363.
“El-Esnevij”, 3/167-171.
32. “El-Um”, 7/277.
33. “Err-Rrisaleti”, 507.
34. “Mulehas Ibtalil Kijas verr-Rreëji vel Istihasani li Ibni Hazm”, 50.
“El-Ihkam fi usulil-Ehkam lehu”, 6/709.
35. “Keshful Esrarë”, 2/1125.
36. “Keshful Esrarë”, 2/1123.
37. “Irshadul Fuhulë li Shevkaniji”, 212.
38. Ibid.

Përmbajtja:

BURIMET (ARGUMENTET) MBËSHTETËSE (PLOTËSUESE) TË LIGJEVE OSE ARGUMENTET PËR TË CILAT DIJETARËT NUK JANË PAJTUAR.....	4
<i>Istihsani</i>	6
Tema e parë: Esenca e istihsanit.....	7
Dallimi në mes të kijasit, istihsanit dhe parimit të interesit	11
Tema e dytë: Llojet e istihsanit	12
Istihsani me tekst (Kur'an dhe Sunet)	15
Istihsani me ixhmaë	17
Istihsani me traditë (zakon)	18
Istihsani prej domosdoshmërisë.....	19
Istihsani me kijasin e fshehtë	20
Istihsani i interesit.....	21
Tema e tretë: Argumentimi i istihsanit dhe mendimet e dijetarëve për të (istihsanin)	23
Vërejtjet	25